



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 321, Datë 12.12.2022

MBI

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN AVENUE”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË  
POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039 prot., datë 06.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “SUN AVENUE” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2014 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet

për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A)

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi aplikimi rezulton se shoqëria “SUN AVENUE” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 2.1, gërmat “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

*Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitonte në ERE Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për administratorin me datë të rifreskuar dhe vërtetimin përkatës për vetë shoqërinë “SUN AVENUE” sh.p.k.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë strukturën organizative të saj, të nënshkruar dhe/ose vulosur.

*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dhe pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat nuk rezultojnë të publikuara as në ekstraktin historik tregtar të QKB-së.  
Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes financiare për financimin e projektit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës referuar vlerës së investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.
- **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë planin e biznesit origjinal ose fotokopje të njëjësuar me origjinalin.

**Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të plotësojë datën e fillimit të operimit të centralit dhe të bëjë me dije nëse ka filluar punimet apo fazën në të cilën ndodhen ato. Gjithashtu, shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 30 viteve të centralit fotovoltaik, pasi nga

rastet analoge, rezulton se teknikisht një panel nuk mund të ketë një jetëgjatësi më të madhe se 25 vite.

- **gërma “b”**: Shoqëria duhet të depozitojë Kontratën nr. 2773 Rep., nr. 876 Kol., datë 23.09.2022, në formatin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
  - **gërma “c”**: Shoqëria duhet të depozitojë shkresën e OSSH sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes në formatin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUN AVENUE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për alikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga

i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Petrit AHMETI**